



Vaksinimi i përforcuar me një vaksinë mARN (Pfizer/BioNTech, Moderna)

Vaksinat mARN mbrojnë shumë mirë nga sëmundjet e rënda të Covid-19 me shtrimin në spital. Por për personat mbi 65 vjeç tregohet që kjo mbrojtje e vaksinimit mund të bjerë me kohën. Për këta persona rekomandojmë një vaksinim të përforcuar duke filluar që 4 muaj pas vaksinimit të fundit. Deri më tani ende është e paqartë, nëse mbrojtja e vaksinimit nga sëmundjet e rënda bie për personat nën 65 vjeç dhe për variantet e reja të virusit. Kurse mbrojtja nga një sëmundje e butë si dhe transmetimi i virusit bie për të gjithë personave nëpërmjet kohës. Kjo gjë mund të ndodhë më shpejt ose më ngadalë në varësi të variantit. Prandaj ne rekomandojmë gjithashtu një vaksinim të përforcuar për të gjithë personat nga 16 deri në 64 vjeç.

Përse shërben një vaksinim i përforcuar?

Nëpërmjet vaksinimit të përforcuar sistemi imunitar kujtohet për mikrobën patogjen. Një mbrojtje e shtuar e vaksinimit riprodhohet dhe zgjatet.

Kujt i rekomandohet vaksinimi përforcues?

Për një mbrojtje më të mirë të mundshme nga sëmundja e rëndë e Covid-19 me shtrimin në spital rekomandohet vaksinimi përforcues për të gjithë personat mbi 65 vjeç. Në veçanti për:

- Personat mbi 75 vjeç;
- Personat mbi 65 vjeç me sëmundje kronike me rrezik¹ më të lartë për një sëmundje të rëndë me Covid-19;
- Banoret, banorët dhe kujdestarët në azilet e të moshuarve, azilet e përkujdesjes si dhe institucionet e përkujdesjes ditore për njerëzit në moshë.

Vaksinimi i përforcuar te personat nën 65 vjeç mund të ndihmojë për të rritur mbrojtjen nga infektimet dhe sëmundjet e buta dhe pasojat e tyre (p.sh. pasojat për një kohë të gjatë nga Covid-19, humbja e punës) dhe për të ulur përkohësisht qarkullimin e virusit. Prandaj vaksinimi përforcues rekomandohet gjithashtu për të gjithë personat nga 16 deri 64 vjeç. Në veçanti për:

- Personat veçanërisht të rrezikuar nën 65 vjeç me sëmundje kronike me rrezik¹ më të lartë për një sëmundje të rëndë me Covid-19.
- Banoret/banorët dhe kujdestarët nën 65 vjeç në azilet e të moshuarve, azilet e përkujdesjes si dhe institucionet e përkujdesjes ditore për njerëzit në moshë.
Personelin shëndetësor me kontakt direkt të pacienti dhe personelin e përkujdesjes për personat veçanërisht të rrezikuar.

Vaksinimi i përforcuar rekomandohet gjithashtu edhe për gratë shtatzëna duke filluar nga tremujori i 2-të i shtatzënisë dhe për gratë që ushqejnë me gjë.

Kur duhet të bëhet vaksinimi i përforcuar?

Një vaksinim i përforcuar rekomandohet duke filluar 4muaj pas imunizimit të plotë bazë me një vaksinë mARN. Një imunizim i plotë bazë përbëhet pas

- dy dozave të vaksinimit të një vaksine mARN; ose
- një infektimi të konfirmuar me koronavirus + një dozë vaksinimi të një vaksine mARN në periudhë kohore të paktën 4 javë (pavarësisht nga rendi).

¹ Tabela 2, fq. 11 rekomandimi për vaksinimin me vaksinë mARN: *Përcaktimet e sëmundjes për personat me sëmundje kronike me rrezik më të lartë (në shqip)*

Nëse pas imunizimit të plotë bazë me një vaksinë mARN është konfirmuar një infektim me koronavirus, vlen si më poshtë:

- Në rastin e infektimit brenda 4 muajve pas imunizimit bazë rekomandohet një vaksinim përforcues 4muaj pas këtij infektimi.
- Në rastin e një infektimi në më shumë se 4 muaj pas imunizimit bazë aktualisht sipas rregullit nuk është i nevojshëm asnjë vaksinim përforcues.

Me cilën vaksinë dhe cilin dozim bëhet vaksinimi përforcues?

Në parim, për vaksinimin përforcues duhet përdorur mundësisht e njëjta vaksinë si ajo për imunizimin bazë. Nëse kjo nuk është e disponueshme, mund të përdoret gjithashtu gjithnjë edhe vaksinë tjetër mARN. Nëse për imunizimin bazë janë përdorur vaksina të ndryshme mARN, vaksinimi përforcues mund të bëhet me një nga të dy vaksinat.

Si tek imunizimi bazë për personat nën 30 vjeç rekomandohet kryesisht vaksinimi përforcues me vaksinën e Pfizer/BioNTech.

Në rastin e vaksinës së Pfizer/BioNTech, për vaksinimin përforcues jepet e njëjta dozë si tek imunizimi bazë. Në rastin e vaksinës së Moderna-s, për vaksinimin përforcues jepet gjysma e dozës.

Ku mund të vaksinohem?

Përgjegjëse për vaksinimin janë kantonet. Informohuni në faqen e internetit ose në linjën informuese të kantonit tuaj (www.foph-coronavirus.ch/cantons), ku mund të regjistroni dhe të vaksinoheni. Ose pyesni mjeken tuaj, mjekun tuaj, farmacistin tuaj ose farmacistin tuaj.

Informacionet e tjera për vaksinimin përforcues janë të njëjta si për imunizimin bazë dhe mund të lexohen në broshurën "Informacione të përgjithshme për vaksinimin kundër Covid-19 me një vaksinë mARN".